



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:095244

Datë: 01.03.2021

Numri i dokumentit: 01552172

P.nr.824/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit T.A. nga fshati B., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 325 paragrafi 1 i KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1363/2018, të datës 14.09.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 03.03.2021, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 02.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri T.A., nga babai H. dhe nëna Sh., e lindur Rr., i lindur me datë .... në Gjilan, ndërsa me vendbanim në fshatin Zh., Komuna e Gjilanit, i pa martuar, i papunësuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 09.04.2019, rreth orës 16:30 minuta, në fshatin Zh., Komuna e Gjilanit, në lagjen e “Pecollëve”, i pandehuri me dashje i ka shkakuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit G.A., në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke e drejtuar veturën e tij të markës “Golf II”, ngjyrë e bardhë, vetura bie në një gropë në ujë dhe e lag të pandehurin i cili ishte duke ecur rrugës në këmbë më pas i pandehuri ofrohet tek vetura e të dëmtuarit dhe shkëmbejnë disa fyerje mes vete dhe në ato momente i dëmtuari del nga vetura dhe pas mosmarrëveshjeve dhe fyerjeve mes vete, i pandehuri me grushtin e dorës së djathtë e godet të dëmtuarin tri-katër herë në pjesën e majtë të fytyrës rreth syrit të majtë ku i dëmtuari rrëzohet në tokë ndërsa i pandehuri largohet me ç’rast i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore i cili kërkon ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan-Emergenca.

-Me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 i KPRK-ës,

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,41,42,43,46,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurin T.A.:

## E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro) të cilën i pandehuri i lartcekur obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

I dëmtuari G.A., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohen i pandehuri i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), shumën prej 20 € (njëzet euro) për përpilimin e ekspertizës mjekoligjore si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### 1.Rriedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 25.04.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.601/19, kundër të pandehurit T.A. nga fshati Zhegër, Komuna e Gjiilanit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 i KPRK-ës.

Më datë 16.02.2021, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri T.A. në të cilën seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri i lartcekur ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin fajësisë nga ana e të pandehurit.

### 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë palët e lartcekura pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë e të pandehurit T.A. ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk kanë qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2019-CA-0358, i datës 09.04.2019, deklarata e të dëmtuarit G.A., deklarata e dëshmitarëve K.A. dhe Sh.Z., deklarata e të pandehurit T.A., raporti mjekësor me numër 8491 i datës 09.04.2019, në emër të të dëmtuarit, ekspertiza mjekoligjore me numër 44.04-19 e datës 24.04.2019, në emër të të dëmtuarit, raporti oficerit si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri T.A. dhe Kenan Isufi nga fshati Zhegër, Komuna e Gjilanit, ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 i KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh rrethanat personale të kryesve dhe shkallën e përgjegjësisë penale të kryesve e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse të pandehurit me rastin e kryerjes së veprës penale kanë qenë i përgjegjshëm për veprimet e tyre. Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 74të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurit gjykata mori faktin se të njëjtit kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, të njëjtit janë penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tyre, i kanë kërkuar falje të dëmtuarit për këto veprime duke shtuar se këto veprime i ka bërë për shkak të gjendjes së varfër ekonomike dhe duke shtuar të njëjtit janë të gatshëm që t'ia kompensojnë dëmin e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, faktin se të njëjtit kanë premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e tyre meqenëse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se të njëjtit këtë vepër penale e kanë kryer me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete.

Gjithashtu duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 76 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### 5.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarën KEDS, e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

#### 6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 € (njëzet euro), shumë prej 20 € (njëzet eurove) për përpilimin e ekspertizës mjekoligjore si dhe shumë prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.390/2019, me datë 01.03.2021

Zyrtare ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.